

VENDIM
Nr. 174, datë 4.11.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/1 prot., datë 22.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 138, datë 21.8.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
 - Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 62/26 prot., datë 25.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k.
 - Me shkresën nr. 997/1 prot., datë 26.8.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
 - Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., në përgjigje të ERE-s, me shkresën nr. 997/3, datë 10.9.2020, ka përcjellë kryesisht dokumentacionin përkatës, por duke qenë se u konstatua ende mungesë dokumentacioni ERE, me shkresën nr. 997/4 prot., datë 22.9.2020, iu drejtua sërish shoqërisë për pjesën e mbetur. Shoqëria, në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997/5 prot., datë 15.10.2020, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.
 - Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 7.8.2017, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB), me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).
 - Aplikimi i shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Format i dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti